



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1395 Prot.

Tiranë, më 07.11 2019

VENDIM Nr. 232, datë 31.10.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 12, datë 31.10.2019, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren për gjetjet arkeologjike rastësore të zbuluara gjatë punimeve për *shtyllën elektrike të N/Stacionit 35 kV, subjekti OSHEE sh.a*, fshati Pojan, Fier. Realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, ZAKPA - Apoloni dhe DRKK - Durrës

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren për gjetjet arkeologjike rastësore të zbuluara gjatë punimeve për *shtyllën elektrike të N/Stacionit 35 kV, subjekti OSHEE sh.a*, fshati Pojan, Fier. Realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, ZAKPA - Apoloni dhe DRKK - Durrës.
2. Subjekti "*OSHEE sh.a*" duhet të bëjë aplikim pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik për miratim të projektit "*N/Stacionit 35 kV*", *Pojan, Fier*.
3. Subjekti "*OSHEE sh.a*", duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të kryejë gërmimin arkeologjik të shpëtimit për projektin *shtyllën elektrike të N/Stacionit 35 kV*, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
4. Raporti me rezultatet e gërmimit të shpëtimit të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrjen në mbledhjen e radhës së KKA.
5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al